



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 19.05.2026

**MBLEDHJA Nr. 23,
Datë 21.05.2026, ora 09:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 21.05.2026, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 23 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi fillimin e procedurës për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.04.2023, “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 MW.
4. Mbi kërkesën për pezullimin e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “VOKOPOLA ENERGJI” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.06.2022.
5. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 09.09.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “AMEL ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 MW”.
6. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.02.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “EB ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.
7. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 41, datë 14.02.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.

8. Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.
9. Mbi kërkesën e shoqërisë “NRG POWER” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
10. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI